



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Raporti i Vetëvlerësimit

2016-2017

Komisioni i Vetëvlerësimit

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, TETOVË, NËNTOR 2017

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	3
2.	Të arriturat	4
3.	Struktura: fakultetet dhe qendrat.....	4
3.1.	Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë	5
3.2.	Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore	5
3.3.	Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit	6
3.4.	Fakulteti i drejtësisë.....	6
3.5.	Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike	7
3.6.	Qendra e gjuhëve	7
3.7.	Qendra e-Learning.....	8
4.	Sigurimi i cilësisë	8
5.	Mësimdhënia dhe të mësuarit	9
5.1.	Programet dhe statusi	9
5.2.	Regjistrimi i studentëve	9
5.3.	Kalueshmëria e studentëve	10
5.4.	Diplomimi i studentëve.....	11
5.5.	Qendra e karrierës dhe punësueshmëria	12
5.6.	Asociacioni Alumni.....	13
6.	Hulumtimi	13
6.1.	Instituti hulumtues “Max Van der Stoel”	14
6.2.	Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit	15
6.3.	Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare	16
7.	Ndërmarrësia dhe zhvillimi	17
8.	Financimi	18
9.	Mjedisi dhe shërbimet në kampus.....	18
9.1.	Mbështetja studentore.....	18
9.2.	Ngrahinat dhe kapacitetet teknike	19
9.3.	Qendra e UEJL-së në Shkup	20
9.4.	Burimet njerëzore.....	21
9.5.	Sistemet e informacionit	22
9.6.	Shërbimet e bibliotekës.....	23
9.7.	Parlamenti dhe Asociacioni studentor.....	24
9.8.	Sporti dhe rekreacioni	24
10.	Konkluzionet	26
	Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit	27

1. Hyrje

Ky raport përfshin periudhën kohore nga 1 shtatori 2016 deri në 31 gusht 2017. Gjatë kësaj periudhe, Universiteti ka shënuar përvjetorin e pesëmbëdhjetë.

Universiteti i Evropës Juglindore ofron studime në tri cikle në pesë fusha kryesore të studimit, të përfaqësuar nga fakultetet përbërëse të UEJL-së: Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore; Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit; Fakulteti i drejtësisë; dhe Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike. Universiteti ka dy kampuse: i pari dhe më i madhi, gjendet në Tetovë dhe i dyti gjendet në Shkup. Përderisa pjesa më e madhe e numrit të studentëve të regjistruar janë nga Republika e Maqedonisë, Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon të tërheqë një numër të madh të studentëve në studimet e magjistraturës dhe doktoratës nga Maqedonia dhe vendet e afërta të rajonit.

Universiteti ka nisma të shumëfishta për të zgjeruar ndikimin e tij vendor dhe për të ndikuar në komunitetin e menjëhershëm në të cilin vepron. Parku teknologjik i UEJL-së ka për qëllim t'u japë bizneseve fillestare një mundësi të hershme për të zhvilluar hulumtimet dhe idetë e tyre duke pasur qasje në burimet dhe komunitetin e Universitetit. Qendra eLearning e UEJL-së koordinon të gjithë procesin e të mësuarit elektronik dhe në distancë për Universitetin, dhe në periudhën e mbuluar nga ky raport e ka mbartur sistemin e menaxhimit elektronik të mësimin në *Google Classroom* (klasën gугëll). Qendra e gjuhëve siguron mësimdhënie dhe teste gjuhësore për të gjithë studentët në studimet universitare, pavarësisht nga programi në të cilin studiojnë, e cila gjë e ndihmon Universitetin ta përdorë politikën e tij të "përdorimit fleksibël të gjuhëve".

Përkundër sukseseve, Universiteti vazhdon të përballet me një mjedis sfidues të arsimit të lartë. Brezat e studentëve që duhet të regjistrohen gjatë periudhës së këtij raporti kanë lindur në vitin 1999 ose 2000, të cilat kanë qenë vite tensionesh në Republikën e Maqedonisë dhe si pasojë ka pasur rënie të numrit të lindjeve. Ngjashëm, emigrimi ka reduktuar më tej numrin e studentëve në dispozicion që kërkojnë hyrjen në institucionet e arsimit të lartë. Universitetet shtetërore të shumëllojshme vazhdojnë të funksionojnë në Republikën e Maqedonisë, si dhe programet e shpërndara që rrjedhin prej tyre drejtohen në qytete të vogla, si dhe një numër i konsiderueshëm i kolegjeve arsimore private, duke rezultuar në një konkurrencë të konsiderueshme për studentët.

Megjithëse sfidat me të cilat përballet UEJL duhet të plotësohen me kreativitet dhe zgjidhje, dëshmia e qëndrueshme është se UEJL mbetet në përputhje me misionin dhe angazhimin e tij për arsim cilësor. UEJL mbetet universiteti jo shtetëror në Republikën e Maqedonisë i ranguar më lartë dhe universiteti më i ranguar lartë që ofron oferta të konsiderueshme arsimore në gjuhën shqipe. Në periudhën e mbuluar nga ky raport, qeveria e Republikës së Maqedonisë përsëri njohu dhe mbështeti aktivitetet e UEJL-së me një donacion bujar prej 500.000 eurosh. UEJL vazhdon të ofrojë standardet ndërkombëtare të arsimit, pavarësisht gjuhës amtare, besimit fetar, bindjeve politike, gjinisë, apo përkatësisë etnike. UEJL mbetet një vend ku njerëzit me prejardhje, shtetësi dhe kombësi të ndryshme takohen për të punuar në mënyrë bashkëpunuese për të përgatitur studentët për sfidat e së ardhmes. Me këtë, UEJL mbetet në përputhje edhe me nevojat aktuale pedagogjike, ashtu edhe me vizionin original themelues të Maks van der Shtulit.

2. Të arriturat

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, kontributi i rëndësishëm i Universitetit të Evropës Juglindore në arsimin terciar u njoh dhe u mbështet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e cila siguroi një subvencion financiar prej 500.000 eurosh. Këto para i mundësuan Universitetit të vazhdojë programin e bursave studentore, me anë të të cilit mbështetja financiare është e lidhur me suksesin e mëparshëm akademik në shkollën e mesme. Me këtë hap synohet që të sillen studentët më të mirë në UEJL, pavarësisht nga rrethanat ekonomike të familjeve të tyre.

UEJL vazhdon të jetë gjithashtu një vend ku partnerët dhe mysafirët ndërkombëtarë takohen për të diskutuar çështje me rëndësi edukative dhe politike. Në periudhën e këtij vlerësimi Universiteti kishte nderin të priste ambasadorët e Bashkimit Evropian, Francës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Polonisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përveç kësaj, mysafirët dhe përfaqësuesit e partnerëve themelues, si OSBE, vazhduan ta vizitojnë Universitetin dhe ta demonstrojnë interesin dhe angazhimin e tyre për UEJL-në.

Universiteti mbajti përkushtimin e tij për shkëmbimin e lirë të ideve dhe hulumtimeve dhe organizoi konferenca, simpoziume, seminare dhe punëtori të shumta gjatë periudhës midis shtatorit 2016 dhe gushtit 2017. Shtrirja e këtyre tubimeve tregon gjerësinë e aktivitetit intelektual në UEJL: Universiteti gjatë kësaj periudhe organizoi konferenca në këto tema: "Ndërtimi i urave ndërmjet hulumtimeve në biznes dhe kërkesave të industrisë"; "Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan," "Albanologët e rinj: sfidat e albanologjisë në fillim të shekullit 21," dhe "Konferenca ndërkombëtare për reformat gjyqësore dhe praktikat kundër korrupsionit." Përveç kësaj, studentët e Fakultetit të drejtësisë organizuan konferencën e parë për studentët e drejtësisë, një takim që ata synojnë të përsërisin çdo vit.

Në prill të vitit 2017, UEJL nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Arsimit të Kosovës dhe Ministrinë e Arsimit të Maqedonisë. Dokumenti u nënshkrua personalisht në një ceremoni zyrtare nga rektori i UEJL-së, Zamir Dika dhe ministrat përkatës të arsimit të vendeve të tyre. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të sigurojë bursa për studentët që regjistrohen në programin e përbashkët - të ofruar nga UEJL dhe Universiteti i Lubjanës - në fushën e Studimeve evropiane.

Bashkëpunimi i UEJL-së me organizatat ndërkombëtare vazhdoi, sidomos me vazhdimin e projektit të administruar nga UEJL "Fëmijët me vështirësi në shikim", i cili sponsorizohet nga Fondacioni Ndërkombëtar Lions Club dhe USAID. Ky projekt është dizajnuar për të zbuluar dëmtimet vizuale tek fëmijët e moshës shkollë në Republikën e Maqedonisë dhe për të lehtësuar qasjen arsimore për fëmijët me shikim të dëmtuar. Projekti zbatohet në qendra në të gjithë territorin e Maqedonisë dhe rinovimi i fazës së dytë të projektit rrit ndjeshëm mbështetjen financiare të ofruar nga donatorët.

Universiteti gjithashtu kishte nderin që të nderonte me titullin *honoris causa* njërin nga anëtarët themelues të Universitetit të Evropës Juglindore, Prof. Jan de Groof.

3. Struktura: fakultetet dhe qendrat

Universiteti i Evropës Juglindore operon me dy kampuse universitare në Tetovë dhe në Shkup. Struktura e universitetit përbëhet nga pesë fakultetet:

- ❖ Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë;
- ❖ Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore;
- ❖ Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit;
- ❖ Fakulteti i drejtësisë dhe
- ❖ Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike.

Me përjashtim të programeve për diplomë, mësimdhënia e gjuhëve (ofrohet nga Qendra e gjuhëve), shkathtësitë e TI (ofrohen nga Qendra për eLearning) dhe lëndët 'zgjedhore të lira' (ofrohen për të gjitha disiplinat), studentët kryesisht studiojnë në fakultetin e zgjedhur në fillim. Hulumtimi ndërmerret nga studentët dhe stafi në mënyrë individuale; hulumtimi kolektiv shpesh ndërmerret në marrëveshje me fakultetin, ose në kuadër të Institutit hulumtues (Max van der Stoel dhe Institutit të mjedisit jetësor dhe shëndetësisë) dhe Zyrës për hulumtim.

3.1. Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë

Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë vazhdon të jetë fakulteti më i madh në Universitet, si në aspektin e regjistrimit të studentëve ashtu edhe në numrin e stafit akademik. Fakulteti ofron studime në të tri ciklet, me tri programe në ciklin e parë, nëntë programe në ciklin e dytë dhe dy programe në ciklin e tretë. B&E ka akredituar dy programe të specializuara në këtë periudhë: Menaxhimi profesional i shitjes; dhe Menaxhimi profesional me logjistikë dhe zinxhir të furnizimit. Fakulteti gjithashtu filloi një proces të vëzhgimit nga kolegët (peer review) në këtë vit akademik, përveç procesit qendror të vëzhgimit të mësimdhënies.

Fakulteti i B&E ka qenë aktiv në fusha të shumta gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Fakulteti themeloi Akademinë e biznesit, me përfaqësues nga sipërmarrësit vendorë dhe industria, si dhe së bashku me përfaqësuesit e UEJL-së, për të thelluar bashkëpunimin midis akademisë dhe biznesit. Fakulteti organizoi një konferencë në shkurt të vitit 2017 me titull "Ndërtimi i urave midis hulumtimit në biznes dhe nevojave të industrisë", i cili tërhoqi mysafirë nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Gjeorgjia, Ukraina dhe vendet e tjera evropiane. Fakulteti gjithashtu mori pjesë në projektin rajonal "Përfshirja e bazuar në mentorim në programet e studimit të biznesit dhe ekonomisë me një fokus rajonal në Ballkanin Perëndimor", një projekt i udhëhequr nga Universiteti i Paderbornit dhe partnerë janë universitetet e Nishit dhe Sarajevës. B&E organizoi dy tryeza të rrumbullakëta, 'Edukimi për punësimin' dhe 'Dinamika e angazhimit të grave në jetën ekonomike-sociale: rasti i Maqedonisë'. Së fundmi, Fakulteti kishte nderin të ishte nikoqir i Prof. Paul Koku-t, nga Universiteti Atlantik i Floridës, i cili dha mësim në B&E dhe ndihmoi themelimin e Klubit të liderëve të ardhshëm në biznes.

3.2. Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore

Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore vazhdoi të ofrojë studime në të tri ciklet me fokus kryesor në shkencat kompjuterike, teknologjitë dhe në shkathtësitë. Me vazhdimin e tendencës së kohëve të fundit, SHTB ka norma relativisht të larta të punësueshmërisë së studentëve të diplomuar. Numri i studentëve të regjistruar në SHTB në vitin akademik 2016-2017 ishte më i lartë se në vitin e mëparshëm akademik.

Jashtë klasës dhe laboratorëve, fokusi kryesor i Fakultetit SHTB në periudhën e këtij raporti ka qenë: 1) Ndërtimi i marrëdhënieve më të forta me komunitetet vendore dhe ndërkombëtare të biznesit dhe sipërmarrjeve dhe 2) Ngritja e profilit ndërkombëtar të programeve, mësimdhënësve, studentëve, dhe alumnit të SHTB. Në mbështetje të këtyre synimeve, SHTB ka bashkëpunuar me TechParkun e UEJL-së dhe ka pasur 15 anëtarë të stafit që kanë marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare në fushat e tyre të specializimit të hulumtimit. Dy anëtarë të stafit të SHTB morën pjesë në programin e zhvillimit të stafit të Universitetit Kiel. Së fundi, SHTB vazhdon të shërbejë si partner në projektin e financuar nga Zvicra "Fuqizimi i rolit të vendeve të prodhimit të Evropës Lindore në rrjetet e prodhimit: Ndikimi i kapaciteteve absorbuese.'

3.3. Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit

Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit vazhdoi të ofrojë mësimdhënie në fushat e lidhura me gjuhët, përkthimin, mësimdhënien dhe studimet e komunikimit. Fakulteti është unik në nivel të Universitetit duke u përbërë nga katër departamente formale: departamenti i gjuhës dhe letërsisë shqipe (studime pasuniversitare); departamenti i gjuhës dhe letërsisë angleze; departamenti i gjuhës dhe letërsisë gjermane; dhe departamenti i komunikimit ndërkombëtar.

Në periudhën e këtij raporti, GJKK regjistroi numrin më të madh të shkëmbimeve studentore të mobilitetit Erasmus në Universitet. Nga GJKK 13 studentë kaluan një semestër jashtë vendit, duke ndjekur studimet në mënyrë të ndryshme si në Universitetet e Kalabrisë, Dalarnas, Grac, Heidelberg, Klagenfurt, Lubjanë dhe Maribor. Përveç kësaj, fakulteti vazhdoi bashkëpunimin me Universitetin ZUG në Zvicër, si në aspektin e shkëmbimit të mobilitetit të studentëve dhe në vazhdimin e një projekti mbi autonominë e nxënësve në arsimin e lartë, i cili synon të zhvillojë një mjet vetëvlerësimi për matjen e autonomisë së mësimin të gjuhëve. Stafi i GJKK gjithashtu mori pjesë në shkëmbimet e lëvizshmërisë akademike, dhe mbajti një shkallë të lartë të botimit në revistat përkatëse akademike.

3.4. Fakulteti i drejtësisë

Fakulteti i drejtësisë ofron studime në fushën e studimeve juridike dhe të kriminalistikës në ciklin e parë të studimeve, me një ofertë që zgjerohet në ciklin e dytë dhe të tretë duke përfshirë të drejtën penale, të drejtën civile dhe studimet e sigurisë. Fokusi i Fakultetit të drejtësisë është në një bashkim produktiv të të kuptuarit teorik, kontekstit historik dhe praktikës së aplikueshme.

Gjatë periudhës së këtij rishikimi, Fakulteti i drejtësisë organizoi (me MVDSRI) një konferencë ndërkombëtare të titulluar "Reformat gjyqësore dhe praktikat kundër korrupsionit: sfidat, perspektivat dhe shkëmbimi i përvojave"; përveç kësaj, studentët e Fakultetit të drejtësisë organizuan konferencën e parë vjetore të studentëve. Fakulteti krijoi (në bashkëpunim me Fakultetin e SHTB) një program të magistraturës në parandalimin e krimit kibernetikë dhe legjisacionin në këtë lëmi. Studentët e fakultetit morën pjesë me sukses në gjykatën simuluese në të drejtën penale të mbajtur në Universitetin 'Goce Dellçev' në Shtip. Studentët e Fakultetit të drejtësisë gjithashtu morën pjesë në Ditën e Hapur duke mbajtur një gjykatë simuluese për qëllime demonstruese. Fakulteti nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e programit për përgatitje për provimit të avokatisë. Së fundmi,

Fakulteti i drejtësisë gjithashtu vazhdoi përpjekjet e para për të ofruar studime në gjuhën turke për studentët me shtetësi turke dhe ka ndërtuar një infrastrukturë efektive të mbështetjes së brendshme për studentët turq.

3.5. Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike

Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike ofron studime në këto fusha të lidhura në të tri ciklet e studimit. Gjatë periudhës së këtij raporti, fakulteti mbajti nivelin më të lartë të kalueshmërisë së studentëve në të gjithë Universitetin, si dhe përqindjen më të lartë të diplomimit në kohë. Fakulteti i konsideron këta shënues si indikacione veçanërisht të rëndësishme të suksesit arsimor.

Në vitin akademik 2016-2017, Fakulteti i APSHP bëri një rishikim të rëndësishëm të kurrikulave, duke përfshirë riakreditimin e programeve bazuar në rishikimin e jashtëm dhe vëzhgimin e brendshëm të mangësive dhe mundësive. Fakulteti gjithashtu ka rishikuar lëndët kryesore në studimet e magjistraturës për qëllimet e hartimit të kurrikulës, si dhe duke rishikuar në thelb programin e studimit për studimet politike (për të arritur elemente të jashtme dhe praktike). Stafi akademik nga APSHP është i angazhuar në shkëmbimet ndërkombëtare, ku një anëtar i stafit ka shkuar në Lubjanë dhe një profesor i Lubjanës ka vizituar APSHP. Së fundi, një iniciativë e madhe e Fakultetit të APSHP ishte përpjekja për të ndërtuar mekanizma më të fuqishëm të mbështetjes së studentëve, duke përfshirë konsultimin dhe bashkëpunimin me Qendrën e karrierës dhe duke krijuar përcaktuesit e arritjeve për të vendosur standardet e fakultetit të normave të kalueshmërisë.

3.6. Qendra e gjuhëve

Qendra e gjuhëve në UEJL ofron gjithë mësimdhënien e gjuhëve në nivel të Universitetit, por jo në shkallë diplome. Si e tillë, QGJ ofron shërbime për studentët nga të gjitha fakultetet, në mbështetje të mandatit të barazisë gjuhësore të Universitetit dhe në funksion të politikës të “përdorimit fleksibël të gjuhëve”. Është një nga komponentët më të mëdhenj të Universitetit në aspektin e madhësisë së stafit dhe ndan me qendrën eLearning karakteristikën e shërbimit të pothuajse të gjithë studentëve të UEJL-së gjatë karrierës së tyre akademike.

Në periudhën e këtij rishikimi, fokusi kryesor i Qendrës së gjuhëve mbetet mësimdhënia kurrikulare. Stafi ka pasur një orar të ngjeshur të mësimdhënies, në krye të të cilit ata organizuan teste të zotërimit të gjuhëve për semestrat 2, 3 dhe 5. Stafi i QGJ mbetën nga më produktivët sa i përket hulumtimit në nivel të Universitetit, me 13 punime të botuara në revista ndërkombëtare, 8 në revista kombëtare, 16 prezantime në konferenca ndërkombëtare, 8 prezantime në konferenca kombëtare dhe 1 pjesëmarrës në një projekt hulumtues ndërkombëtar. QGJ gjithashtu ka shërbyer si burim i rëndësishëm për involvim të komunitetit dhe gjenerimit të të ardhurave, duke ofruar udhëzime gjuhësore për Ambasadën e SHBA-ve, për studentët e UEJL-së-Romaversitas dhe kurse të gjuhës angleze për stafin e Studejsa Petrol. Veç kësaj, si në vitet e kaluara, QGJ ka qenë një element kryesor në planifikimin institucional të rekrutimit dhe orientimit të studentëve, duke përfshirë pjesëmarrjen në vizitat e rekrutimit të shkollave të mesme; organizimi i Panairit të Gjuhës për Ditën e Hapur; duke asistuar Korpusin e paqes dhe Kryqin e Kuq të Ohrit me finalet e “*National Spelling Bee*” në kampusin në Shkup; dhe

angazhimin e vazhdueshëm të GJQ me festimet e "Javës së gjuhës Italiane" dhe projektin 'Le të flasim' për zgjerimin e aftësive të të folurit të studentëve.

3.7. Qendra e-Learning

Qendra e-Learning ka dy përgjegjësi kryesore: ta mbështesë dhe ta monitorojë të gjithë ofrimin online të udhëzimeve dhe detyrave në të tri ciklet dhe ofron trajnime për studentët dhe stafin për teknologjinë kompjuterike dhe shkathtësitë kompjuterike. Ishte përmes veprimit të drejtpërdrejtë të stafit të Qendrës eLearning, që në periudhën e mbuluar nga ky raport, i gjithë rrjeti i lëndëve të Universitetit të mbartet dhe të hapet në *Google Classroom* (klasën gugëll) dhe trajnimi i ofruar për stafin akademik për mënyrën e maksimizimit të shërbimeve të kësaj platforme.

Qendra e-Learning siguron mbështetje dhe asistencë për shumicën e aktiviteteve të Universitetit që përfshijnë kompjuterët në klasë ose në punë apo në shtëpi. Në periudhën e mbuluar nga ky rishikim, aktivitetet e tjera të Qendrës eLearning përfshinin ofrimin e udhëzimeve për personelin, në baza vullnetare, për trajnimin në ECDL, Google Docs, dhe Google Drive. Qendra e-Learning gjithashtu ka ofruar mësimdhënie për studentët e UEJL-së në kuadër të lëndëve "zgjedhore të lira" për këto lëndë: *Advanced IT Skills, Advanced Excel, Kapitujt e zgjedhur në Aplikacionet e TI dhe Aplikacionet për Përpunimin e të Dhënave Statistikore*. Qendra gjithashtu pati një rol udhëheqës në edukimin në komunitet dhe mësimdhënie duke ofruar trajnime për mësuesit dhe nxënësit e shkollave të mesme vendore, duke ofruar marketing të vlefshëm pozitiv për Universitetin.

4. Sigurimi i cilësisë

Zyra për sigurimin e cilësisë e universitetit (Zyra e SC) kujdeset që sigurimi i cilësisë të jetë i pranishëm në të gjitha aktivitetet e Universitetit, duke u përqendruar në ngritjen e standardeve, duke njohur arritjet dhe duke promovuar një kulturë pozitive dhe bashkëpunuese.

Për të mbështetur të mësuarit dhe mësimdhënien efektive, Zyra e SC ka përfunduar me sukses skemën dyvjeçare të vëzhgimit të mësimdhënies në të gjitha fakultetet, me informatë kthyese individuale të ofruara për të gjithë anëtarët e stafit të vëzhguar dhe të përdorura për vlerësimin menaxherial. Një instrument tjetër për sigurimin e cilësisë është përdorur në Fakultetin e administratës publike dhe shkencave politike. Procesi i vlerësimit të mësimdhënies (TAP) ka mbledhur informata relevante nga studentët rreth dy karakteristikave kritike për çdo lëndë: çfarë shkon mirë me lëndën e veçantë - sa i përket mësimit dhe mësimdhënies - dhe çfarë mund të përmirësohet. Përveç këtij informacioni, gjatë vizitave në klasë, studentët u inkurajuan, në mënyrë pozitive dhe konstruktive, që të ofrojnë pikëpamjet e tyre për çështje të ndryshme që lidhen me studimet e tyre. Rezultatet janë diskutuar me çdo profesor veç e veç dhe me menaxhmentin e Fakultetit dhe Universitetit në mënyrë që të përfshihen në plan veprim.

Përpjekjet e Zyrës së SC për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të nxënies si elemente kyçe të aktivitetit të Universitetit përfshijnë gjithashtu ofrimin e trajnimeve të përshtatura për zhvillimet kryesore si vlerësimi, digjitalizimi dhe induksioni i metodologjisë për anëtarët e personelit të sapopranuar në mësimdhënie. Aktivitetet brenda javës së orientimit për studentët e rinj të regjistruar janë planifikuar dhe organizuar nga Zyra e SC.

Zyra e SC është e përfshirë në menaxhimin strategjik të Universitetit duke mbështetur planifikimin e veprimeve në nivelet e Fakultetit me monitorimin e progresit dhe arritjeve. Gjithashtu, siguron që rekomandimet e konsulentëve të jashtëm të jenë inkorporuar dhe të përdoren në mënyrë aktive për zhvillim, së bashku me përfshirjen e tendencave ndërkombëtare. Analiza e të dhënave dhe raportimi nga procedura të ndryshme - siç janë vlerësimi i studentëve nga kurset dhe shërbimet akademike, vëzhgimet e mësimdhënies, si dhe të dhënat e trajnimit - kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm të proceseve kryesore të menaxhimit të performancës. Diskutimet dhe rekomandimet nga mundësitë e trajnimit të cilësisë së lartë të organizuara nga Zyra e SC në janar dhe gusht janë përdorur si bazë për vendosjen e standardeve për performancën akademike dhe administrative, si dhe për modifikimin dhe përmirësimin e procedurave ekzistuese për matjen e cilësisë.

Zyra e SC përpiqet të promovojë vlerën e lartë të kulturës së cilësisë të themeluar në Universitet që e dallon atë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend dhe në rajonin më të gjerë.

5. Mësimdhënia dhe të mësuarit

5.1. Programet dhe statusi

Gjatë periudhës së këtij rishikimi, UEJL ka ofruar studime të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në të gjithë pesë fakultetet. Në programet magjistraturës dhe doktoratës ndiqen leksionet në klasë dhe më vonë bëhet hulumtimi dhe përpilimi i tezës për të cilën organizohet mbrojtje formale publike. Të gjitha tezat e magjistraturës dhe doktoratës së UEJL-së janë mentoruar nga mentorë të akredituar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Maqedonisë dhe janë pothuajse gjithmonë stafi i UEJL-së.

Të dhënat në vazhdim përshkruajnë ciklin e jetës studentore nga regjistrimi deri në diplomim.

5.2. Regjistrimi i studentëve


Tabela 1, paraqet të dhënat Totale të regjistrimit për vitet akademike 2014/2015—2016/2017. Siç shihet, regjistrimet u ulën në mes të viteve akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, megjithëse në vitin akademik 2016-2017 kishte një regjistrim pak më të lartë se në vitin akademik 2014-2015. Lulatjet e përgjithshme janë në përputhje me regjistrimin e rreth 1000 studentëve në çdo vit akademik, me devijime pozitive rreth 20-100.

Viti akademik	Numri i studentëve të regjistruar
2014/2015	1011
2015/2016	1114
2016/2017	1026
Gjithsejtë	3151

TABELA 1. NUMRI I PËRGJITHSHËM SIPAS VITEVE AKADEMIKE

Grafikoni 1, paraqet numrin e regjistrimeve sipas gjuhës së studimeve. Të dhënat paraqesin disa tendenca të qarta. Studimi në gjuhën shqipe vazhdon të jetë në mënyrë të konsiderueshme oferta akademike më e popullarizuar e Universitetit. Ofertat në gjuhën angleze mbeten në vend të dytë, ku përafërsisht një nga pesë studentët e UEJL-së zgjedh të ndjek një lëndë që ofrohet në gjuhën angleze. Për fat të keq, ofertat në gjuhën maqedonase vazhdojnë të jenë në vend të tretë, e cila gjë

ka implikime konsekuente për punësimin, alokimin e burimeve, caktimin dhe në një kuptim më të gjerë, për realizimin e misionit të Universitetit të barazisë dhe paritetit gjuhësor.



GRAF1. NUMRI I PËRGJITHSHËM I REGJISTRIMEVE

Tabela 2, raporton regjistrimet e përgjithshme sipas fakulteteve për tre vitet e fundit. Siç mund të shihet, të gjitha fakultetet kishin një rënie në regjistrimet ndërmjet 2015-2016 dhe 2016-2017, me përjashtim të Fakultetit të gjuhëve, kulturave dhe komunikimeve. Për shumicën e fakulteteve, regjistrimi i vitit 2016-2017 ishte i ngjashëm me atë të 2014-2015, me përjashtim të APSHP (një rritje prej 34 regjistrimeve), GJKK (një rritje prej 41 studentëve) dhe drejtësia (një rënie prej 50 studentësh).

Fakulteti	2014/2015	2015/2016	2016/2017
BE	252	281	253
SHTB	169	166	158
Drejtësia	249	234	199
GJKK	177	209	218
APSHP	164	224	198
Gjithsej	1011	1114	1026

TABELA 2. NUMRI I PËRGJITHSHËM I REGJISTRIMEVE SIPAS FAKULTETEVE

5.3. Kalueshmëria e studentëve

Kalueshmëria e studentëve është një nga treguesit kryesorë të suksesit institucional për çdo universitet. Tabelat 3 dhe 4 paraqesin të dhënat për kalueshmërinë për gjeneratat e studentëve të viteve akademike 2014-2015 dhe 2015-2016. Siç mund të shihet nga të dhënat, Universiteti mban një normë të kalueshmërisë afërsisht 80% pas vitit të parë të studimit, duke rënë në rreth 70% të kalueshmërisë pas vitit të dytë. Fakulteti i administrimit publik dhe sShkencave politike

vazhdimisht ka normat më të larta të kalueshmërisë së studentëve, ndërsa shkalla më e ulët e kalueshmërisë përgjatë viteve të anketuara është Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore.

Gjenerata 2014/15	Student të rregullt 2014/15	Kalueshmëria 2015/16		Kalueshmëria 2016/17	
Fakultetet	Studentët	Kalueshmëria në vitin e 2	%	Kalueshmëria në vitin e 3	%
BE	49	120	80.54%	101	67.79%
SHTB	110	83	75.45%	74	67.27%
Drejtësi	177	142	80.23%	125	70.62%
GJKK	123	99	80.49%	88	71.54%
APSHP	93	83	89.25%	74	79.57%
Gjithsej	652	527	80.83%	462	70.86%

TABELA 3. KALUESHMËRIA PËR GJENERATËN 2014/15

Gjenerata 2015/16	Student të rregullt 2015/16	Kalueshmëria 2016/17		Kalueshmëria 2017/18	
Fakultetet	Studentët	Kalueshmëria në vitin e 2	%	Kalueshmëria në vitin e 3	%
BE	167	130	77.84%	120	71.86%
SHTB	108	91	84.26%	68	62.96%
Drejtësi	146	123	84.25%	109	74.66%
GJKK	115	89	77.39%	81	70.43%
APSHP	124	110	88.71%	95	76.61%
Gjithsej	660	543	82.27%	473	71.67%

TABELA 4. KALUESHMËRIA PËR GJENERATËN 2015/16


5.4. Diplomimi i studentëve

Tabela 5 dhe grafikoni 2, paraqesin të dhëna lidhur me shkallën e diplomimit në kohë. Këto të dhëna tregojnë shkallën e diplomimit në kohë sipas fakulteteve për gjeneratën e studentëve 2014-2015. Diplomimi në kohë përcaktohet si përqindja e studentëve që përfundojnë studimet e tyre në periudhën trevjeçare të synuara nga kurrikula akademike. Të dhënat tregojnë se shkalla më e lartë e diplomimit në kohë për këtë gjeneratë të studentëve është arritur nga Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike, me 40.58%; shkalla më e ulët e diplomimit në kohë për atë gjeneratë është arritur nga Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore, me 5.45%. Mesatarja e Universitetit është zhgënjyese 28.12%, që do të thotë se për çdo 10 studentë të regjistruar, statistikisht më pak se tre mund të diplomohen në kohë.

Fakultetet	Të regjistruar	Të diplomuar	Përqindja
BE	149	55	36.91%
SHTB	110	6	5.45%
Drejtësi	177	38	21.47%
GJKK	123	41	33.33%

APSHP	138	56	40.58%
Gjithsej	697	196	28.12%

TABELA 5. SHKALLA E DIPLOMIMIT NË KOHË PËR GJENERATËN 2014-2015



GRAF2. DIPLOMIMI NË KOHË SIPAS FAKULTETEVE PËR GJENERATËN 2014-2015

5.5. Qendra e karrierës dhe punësueshmëria

Qendra e karrierës e UEJL-së është njësia kryesore e Universitetit që ndihmon hyrjen e studentëve në tregun e punës. Si e tillë, QK mbikëqyr përmbushjen e praktikave të kërkuara të studentëve, dhe përpiqet të krijojë marrëdhënie me komunitetin për të lehtësuar mundësitë shtesë për punë praktike. Qendra gjithashtu organizon panairin vjetor të karrierës, në të cilin kompanitë vendore dhe kombëtare dhe OJQ-të rekrutojnë studentët aktualë dhe ish studentët të UEJL-së. Përveç kësaj, Qendra e karrierës ofron asistencë për shkathtësitë e punës (shkrimin e CV, udhëzime, praktika, intervistë pune, etj), dhe shpërndan njoftimet për vendet e lira të punës. Përfundimisht, Qendra e karrierës gjithashtu zhvillon anketat për punësimin me të posa diplomuarit, për të vlerësuar mundësitë e punësimit dhe vështirësitë e të diplomuarve të UEJL-së (dhe nga të cilat anketa rrjedhin shumica e të dhënave në këtë raport).

Të dhënat tregojnë se shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve për vitin 2015 (grupi më i fundit i të diplomuarve të anketuar) është 41%, por, 7% e tyre raportohen si të papunë sipas zgjedhjes (zakonisht për arsye familjare) dhe 16% të tjerë vazhdojnë studimet e tyre në UEJL ose në ndonjë universitet tjetër. Kështu vlerësohet se shkalla e papunësisë reale e të diplomuarve ka të ngjarë të jetë 36%, prej të cilëve 25% e raportojnë veten si të papunë dhe 11% raportojnë se i vazhdojnë studimet e tyre për shkak të papunësisë.

Kur konsiderohet në aspekt individual sipas fakulteteve, shkalla më e lartë e papunësisë së të diplomuarve është nga Fakulteti i dDrejtësisë, me 58% të papunësisë. Fakulteti i gjuhëve, kKulturave dhe komunikimeve ka shkallën e dytë më të lartë të papunësisë në mesin e të

diplomuarve, me 52%. Fakulteti i administrimit publik dhe sShkencave politike raporton një shkallë papunësie prej 48%, ndërsa Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore raporton një shkallë papunësie prej 34%. Shkalla më e ulët e papunësisë vërtetohet nga Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë, i cili regjistron një normë papunësie prej 31%.

Kur vlerësohet në nivel individual, të diplomuarit meshkuj raportojnë një shkallë më të ulët të papunësisë (44%) sesa femrat e diplomuara (51%). Ka një ndryshim të dukshëm në mesin e etnive: të diplomuarit e përkatësisë etnike shqiptare raportojnë një normë papunësie prej 51%; të diplomuarit e përkatësisë etnike maqedonase raportojnë një normë papunësie prej 31%; dhe të diplomuarit e etnive të tjera raportojnë një shkallë papunësie prej 65%.

Në mënyrë zhgënjyese, suksesi akademik nuk lidhet me punësueshmërinë. Në mesin e të anketuarve, ata të diplomuar me notë mesatare nga 6-7 kishin një shkallë punësimi prej 53%, ndërsa ata të diplomuar me notë mesatare nga 9-10 kishin një shkallë punësimi prej 44%.

Duhet të theksohet se të gjitha këto të dhëna rrjedhin nga vetë-raportimi nga ata të diplomuar që zgjedhën të përgjigjen në sondazhet e Qendrës së karrierës dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur për saktësinë pa shkelur privatësinë dhe konfidencialitetin e diplomuarve.

5.6. Asociacioni Alumni

Asociacioni Alumni i UEJL-së është definuar në Statutin e Universitetit, por nuk ekziston në kuptimin funksional. Kjo paraqet një mundësi të konsiderueshme të humbur për Universitetin dhe për vet alumnin, siç është konstatuar nga vizitat e fundit nga ekipi i ekspertëve nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane.

Përfitimet e asociacionit aktiv të aluminit janë të konsiderueshme. Si të diplomuar të suksesshëm, alumni përfaqëson ambasadorët më efektivë të institucionit. Ata mund të ofrojnë njohuri të vërteta në boshllëqet e shkathtësive në kurrikulat tona aktuale dhe rekomandimet për zhvillimin e ardhshëm të kurrikulave. Alumni gjithashtu shërben potencialisht si bashkëpunëtor i dobishëm për punën praktike dhe angazhimin në aktivitetet e universitetit, pasi UEJL përpiqet t'i ndihmojë studentët në përmbushjen e kërkesës si për punë praktike dhe gjetjen e mundësive për punësim. Punëdhënësit e Alumni, nga ana tjetër, do të kishin një burim të gatshëm të studentëve të kualifikuar që do të diplomoheshin dhe do të njihnin shkathtësitë e pritura nga rekrutët potencialë.

Mosekzistimi i tanishëm i çdo asociacioni Alumni aktiv është ndoshta dështimi më i dukshëm institucional i Universitetit të Evropës Juglindore.

6. Hulumtimi

Në rangimin e fundit sipas Shanghai Jiao Tong, Universiteti i Evropës Juglindore u rendit i dyti në Republikën e Maqedonisë për hulumtim shkencor (prapa universitetit shumë më të madh shtetëror Shën Qirili dhe Metodi). Ky rezultat dëshmon për prioritetin e lartë të vendosur në përsosmërinë e hulumtimit nga UEJL, ashtu si forca e vazhdueshme e programeve të magjistraturës dhe doktoratës të Universitetit, të cilat njihen si të jashtëzakonshme në cilësi në rajon.

Zyra për hulumtim është zyra kryesore për koordinimin dhe mbështetjen e hulumtimit të Universitetit. Si e tillë, ajo siguron administrimin e financimit të hulumtimit (siç është detajuar më poshtë); mbështet punën e Komitetit qendror të hulumtimit; siguron rishikimin e duhur dhe publikimin e *SEEU Review*; jep udhëzime për stafin dhe studentët për vendin më të përshtatshëm shkencor për të prezantuar dhe publikuar punën e tyre; siguron pajtueshmërinë me angazhimet e Universitetit HRS4R; siguron analizën dhe vlerësimin e të dhënave nga baza e të dhënave hulumtuese; ndihmon në propozimet e granteve dhe në aplikimet për projekte; dhe në përgjithësi siguron mbështetje kërkimore, këshilla dhe ndihmë.

UEJL ka filluar një metodë të financimit të hulumtimit unik në Ballkan. Të gjithë anëtarët me kohë të plotë të stafit akademik të UEJL-së kanë të drejtë deri në 700 euro për mbështetje për hulumtim, pjesëmarrje në konferencë, përkthim ose ndihmë editoriale, ose kostot e tjera të lidhura me hulumtimin. Gjatë periudhës së mbuluar nga ky rishikim, Zyra e hulumtimit (nën udhëheqjen e Provostit) miratoi 56.505 euro mbështetje për hulumtimin, të shpërndara si më poshtë: Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë-16,177 euro; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore - 10,197 euro; Fakulteti juridik - 6,857 euro; Qendra e gjuhëve-10,309 euro; Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimeve - 6,560 euro; dhe Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike-6,405 euro. Kjo mbështetje rezultoi në pjesëmarrjen e stafit në konferenca në tri kontinente (Evropë, Azi dhe Amerikën e Veriut) dhe do të thotë se të gjithë anëtarët e stafit akademik janë në gjendje të përmbushnin minimumin e produktivitetit të tyre kontraktual hulumtues.

Zyra e hulumtimit, gjithashtu ka publikuar *SEEU Review* nën siglën e DeGruyter, shtëpi botuese prijatë me qasje të hapur për materialet shkencore. Kjo revistë dyfish e recensuar nga kolegët në mënyrë anonime është një nga vendet kryesore hulumtuese për publikimin e punimeve akademike në gjuhën angleze në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Komiteti qendror i hulumtimit u takua në katër raste të veçanta dhe ka dhënë analiza hulumtuese për rastet për promovim në titull të 19 anëtarëve të stafit.

Në vitin akademik 2017-2018, Universiteti i Evropës Juglindore organizoi konferenca të shumta, ndër të cilat ishin 'Ndërtimi i urave midis hulumtimit në biznes dhe nevojave të industrisë', 'Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan', 'Albanologët e rinj: Sfidat e albanologjisë në fillim të shekullit të 21-të, Konferencën ndërkombëtare për reformat gjyqësore dhe praktikat kundër korrupsionit, si dhe Multikulturalizmi dhe gjuha e kontaktit, i cili u bashkorganizua nga Instituti i Max van der Stoel dhe Qendra për gjuhësi areale të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë.

6.1. Instituti hulumtues “Max Van der Stoel”

Instituti i hulumtues “Max van der Stoel” është njësi kryesore e Universitetit të Evropës Juglindore për organizimin e konferencave. Përveç kësaj, është agjenti kryesor për hulumtim bashkëpunues brenda Universitetit, veçanërisht nëpërmjet mekanizmit të grupeve të tij hulumtuese. Fushat e përgjithshme të hulumtimit ndërdisiplinor për MVDSRI janë diplomacia, parandalimi dhe menaxhimi i konfliktit, studimet kulturore dhe shkencat politike.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky rishikim, MVDSRI priti tri konferenca kryesore. Në shkurt të vitit 2017, Instituti organizoi konferencën mbi 'Ekstremizmin e dhunshëm në Ballkanin Perëndimor: Ndikimi i jashtëm dhe agjentët vendor', e cila u bashkë-organizua nga Programi për ndërtimin e paqes dhe të drejtat e njeriut në Universitetin e Kolumbias në SHBA. Kjo solli rreth 100 studiues, diplomatë dhe ekspertë nga Maqedonia, vende të tjera të Ballkanit dhe SHBA-të. Së dyti, në gusht të vitit 2017, MVDSRI bashkëpunoi me Qendrën për gjuhësi areale të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë për të organizuar konferencën për "Multikulturalizmin dhe gjuhën e kontaktit". Kjo konferencë dyditore, një ditë u mbajt në Tetovë në UEJL dhe një ditë në Shkup në ASHAM, ku u takuan së bashku rreth 30 ekspertë nga SHBA-ja dhe Federata Ruse dhe u paraqitën disa nga gjuhëtarët më të shquar në fushat e gjuhëve të Ballkanit. Së treti, MVDSRI bashkëpunoi me Fakultetin juridik për të organizuar një konferencë mbi "Reformat gjyqësore dhe praktikat kundër korrupsionit."

Përveç organizimit të konferencave, MVDSRI organizoi një sërë forumesh hulumtuese me ligjërues dhe mysafirë të shquar. Ndër ata që i kanë drejtuar këto forume në vitin akademik 2016-2017 ishin *Dr. Christina Kramer*, nga Universiteti i Torontos, e cila foli për "Peizazhin gjuhësor të lëvizshëm"; *Prof. James Pettifer*, nga Kolegji St. Cross, Universiteti i Oksfordit, foli për "Britaninë e Madhe dhe Evropën Juglindore pas Brexit-it"; dhe një forum bashkëpunues me folës nga UEJL, "Shën Qirili dhe Metodi" dhe Fondacioni *Freidrich Ebert* mbi temën e marrëdhënieve të jashtme të Republikës së Maqedonisë.

MVDSRI gjithashtu ka ndihmuar në përgatitjen e aplikacioneve të shumta për projekte në përgjigje të titujve specifike (nga USAID, Komisioni Evropian, UNESCO, etj.). Midis këtyre, Instituti aplikoi për kryesim në Jean Monnet në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare të Ballkanit Perëndimor; dhe u bashkua me Rrjetin Evropian të Përkujtimit dhe Solidaritetit në aplikacion "In Between" një projekt akademik ndërkombëtar i udhëhequr nga ENRS. Gjithashtu, ka përgatitur aplikacionin dhe ka aplikuar për Programin ndërkufitar për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë - Shqipëri në kuadër të instrumentit të ndihmës së Para-Aderimit (IPA II) (Referenca: EuropeAid/152956/DD/ACT/MK), me propozimin e MVDSRI: "Ndërveprimi i trashëgimisë kulturore në Shqipërinë Juglindore dhe Maqedoninë Jugperëndimore, përmes zbatimit të teknikave inovative 3D në vendet arkeologjike; Ndihmë për fëmijët me vështirësi në shikim."

6.2. Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit

Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetin është institut hulumtues i Universitetit të Evropës Juglindore me përgjegjësi për menaxhimin e mjedisit, zvogëlimin e ndikimit atmosferik dhe promovimin e përgjegjesisë ekologjike. Është i vendosur në ndërtesën e Energjisë së qëndrueshme në kampusin e Tetovës dhe ofron mbështetje të përgjithshme për zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor, qoftë përmes asistimit të Komunës së Tetovës në krijimin e Planveprimit klimaterik, përmes avokimit dhe mbikëqyrjes së transformimit të objekteve të UEJL- me teknologji efikase, dhe përmes ofrimit të udhëzimeve të doktoratës dhe mentorimit në fushat e ngjashme.

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, IMJSH ka ndjekur shumë iniciativa. Instituti vazhdoi me zbatimin e projektit NORMAK për efikasitetin e energjisë. Projekti vazhdoi për një periudhë të

kufizuar, me gjashtë muaj shtesë për të aplikuar për fonde shtesë. Së dyti, Instituti zbatoi projektin kërkimor të mbështetur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në lidhje me hulumtimin, projektimin dhe realizimin e pilot projektit për "Matjen e parametrave klimatik përmes rrjetit të stacioneve mobile të vetëqëndrueshme me vizualizimin e vlerave të matura". Së fundi, Instituti filloi përgatitjet për punë në terren për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për ndotjen e ajrit në Kërçovë dhe Kavadar dhe në lidhje me shpalljen e Malit të Sharrit si Park Nacional.

6.3. Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare

Që nga fillimi, Universiteti i Evropës Juglindore ka qenë ndërkombëtar në orientimin, misionin dhe fokusin. Fondet themeluese u siguruan gjerësisht nga organizatat ndërkombëtare ose shtetet individuale dhe iniciativa për Universitetin rrjedh nga puna e një ekipi ndërkombëtar të udhëhequr nga diplomati holandez Max van der Stoel. Që nga themelimi, Universiteti ka vazhduar të sfidojë veten për tu përputhur me standardet dhe trendet ndërkombëtare. Ndërkombëtarizimi mbetet një shtyllë kryesore e Planit strategjik të Universitetit. Prandaj, Universiteti merr pjesë në mënyrë aktive në mobilitetin e stafit dhe studentëve, si për ata që vijnë dhe ata që shkojnë. Universiteti, gjithashtu, mbështet stafin për të prezantuar punimet e tyre në konferenca dhe revista ndërkombëtare. Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon të jetë një vend mikpritës popullor për folësit dhe ligjëruesit e ftuar; gjatë periudhës së këtij rishikimi, Universiteti kishte nderin të priste dy mysafirë Fulbright nga Shtetet e Bashkuara -Prof. Judithanne McLauchlan, nga Universiteti i Floridës së Jugut, e cila ligjëroi në Fakultetin e drejtësisë të UEJL-së, dhe Prof. Paul Koku, nga Universiteti Atlantik i Floridës, i cili dha mësim në Fakultetin e biznesit dhe ekonomisë në UEJL.

Mbështetja kryesore e përpjekjeve për ndërkombëtarizimin e Universitetit sigurohet nga Zyra për marrëdhëniet ndërkombëtare (ZMN). Detyrat kryesore të ZMN-së janë t'i lehtësojnë mundësitë për mobilitet në Erasmus + për studentët dhe stafin; për të ndihmuar dhe orientuar ligjëruesit e ardhshëm vizitues; ZMN krijon dhe mban marrëdhënie me institucionet e tjera, veçanërisht kur formalizohen memorandume të mirëkuptimit ose memorandume të bashkëpunimit; ndihmon dhe mbikëqyr rekrutimin e studentëve turq për programin e gjuhës turke në Fakultetin e drejtësisë.

Për të përcaktuar këto përpjekje, ky raport vë në dukje se për periudhën e këtij rishikimi, UEJL kishte 52 grante për mundësitë për mobilitet në Erasmus +, nga të cilat 42 janë shfrytëzuar. Prej tyre, 31 ishin për studentët dhe 11 ishin për anëtarët e stafit. Vizitat për mobilitet në aspekt të shteteve kanë këtë shpërndarje: Slloveni-9; Gjermani -5; Francë -5; Suedi -4; Kroaci -3; Republika Çeke-3; Austri -2; Lihtenshtajn -2; Lituani -2; Portugali -2; Spanjë -2; Turqi -2; dhe Holandë —1.

Përveç kësaj, gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Universiteti nënshkroi katër marrëveshje Erasmus + me: Universitetin e Splitit, Universitetin e Osijekut, Universitetin e Vistula dhe Universitetin e Lille. UEJL gjithashtu nënshkroi dy Memorandume të mirëkuptimit, me Universitetin e Gjirokastrës dhe LUM Jean Monnet nga Italia.

7. Ndërmarrësia dhe zhvillimi

Universiteti i Evropës Juglindore e konsideron bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe të ndërmarrësisë si një shtyllë qendrore të veprimtarisë së tij. Universiteti synon të jetë një ndërmjetës pozitiv ndërmjet sipërmarrjes dhe akademisë, veçanërisht: 1) duke lehtësuar një bashkëpunim më të madh formal midis botës akademike dhe asaj të biznesit dhe 2) duke minimizuar boshllëqet e aftësive ndërmjet trajnimit akademik dhe tregut praktik të punës. Për të çuar më tej këto synime dhe ambicie, Universiteti krijoi Komitetin e marrëdhënieve me biznesin, i cili ka përfaqësues të menaxhimit ekzekutiv të Universitetit, Qendrën e karrierës dhe dy iniciativa të mëdha të UEJL për të ndërtuar lidhje midis biznesit, industrisë dhe akademisë— *University.com*, dhe *SEEU TechPark*.

Qendra e zhvillimit të biznesit ofron trajnim biznesi dhe këshillim biznesi për individë, kompani dhe institucione të tjera private dhe publike. Përmes QZHB-së, UEJL është një partner i kompanive dhe institucioneve të tjera në aspektin profesional dhe organizativ. Në mënyrë të veçantë, QZHB ndihmon kompanitë në organizimin profesional të konferencave, seminareve dhe takimeve të biznesit, duke shfrytëzuar hapësirat e UEJL –së në kampuset në Tetovë dhe Shkup. Një shërbim shtesë që BDC iu ofron kompanive është promovimi i shërbimeve dhe produkteve të tyre për studentët dhe punonjësit e UEJL-së në forma të ndryshme (email, postera, fletushka). QZHB gjithashtu ndihmon kompanitë në identifikimin e trajnimeve ose mundësive të tjera të ndërtimit të aftësive, dhe ofrimin e udhëzimeve për të përmbushur këto nevoja. Ndër partnerët vendorë më të shquar dhe më të vlefshëm janë: Dauti Komerc, Alkaloid, Sparkasse Bank, Kipper, Lycamobile, Ecolog, Harbini Cosmetics, dhe Ohridska Banka. QZHB gjithashtu ka arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm edhe me Ambasadën Amerikane në Shkup, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Konfederatën e Biznesit të Maqedonisë, Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, DMWV, etj.

SEEU TechPark gjendet në kampusin e Tetovës. I themeluar me vendimin e Bordit të Universitetit në vitin 2013, TechPark është iniciativa kryesore e Universitetit për të mbështetur inkubacionin e biznesit dhe mbështetjen e modelit të hershëm për NVM-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme). Funkcionet kryesore TechPark-ut janë të ndara në tri aktivitete të ndryshme, në veçanti: departamenti i qiramarrjes; departamenti i para-inkubimit/inkubimit; dhe departamenti i trajnimeve dhe ngjarjeve. Departamenti i qiramarrjes është kryesisht përgjegjës për sigurimin e lehtësirave të përshtatshme sipërmarrëse për iniciativat, siç janë vendet fizike; planifikimin, këshillimin dhe asistencën për marketing; dhe lehtësimin e ndërveprimit të qiramarrësve me asistentët dhe të diplomuarit nga universiteti. Departamenti i parainkubimit/inkubimit në mënyrë specifike ofron ndihmë për të nxitur një koncept nga fillimi në realizim, veçanërisht në fushat e TIK. Departamenti i trajnimeve dhe ngjarjeve ofron instruksione dhe forume për ngjarjet ndër të cilat janë ofruar 20 trajnime të ndryshme, veçanërisht mësimdhënie në lidhje me Akademinë Informatike të Microsoftit, Akademinë CISCO, dhe trajnime të përgjithshme të biznesit, planifikimit të marketingut dhe menaxhimit.

Universiteti synon ta mbajë këtë fokus në ndërmarrësi shumë-iniciative, duke besuar se kjo paraqet 1) një mundësi të vlefshme për të diversifikuar rrjedhat e të ardhurave, 2) një bashkëveprim kolektivisht i dobishëm midis akademisë dhe biznesit, 3) mbështetje logjike për shpikësit e

brendshëm, vendor dhe sipërmarrësit, si dhe 4) një formë e komunitetit në të cilin UEJL është lider vendor dhe kombëtar.

8. Financimi

Duke qenë institucion i arsimit të lartë privat-publik jo-fitimprurës, financimi i aktiviteteve të mësimdhënies dhe hulumtimit të Universitetit është mbështetur kryesisht nga institucioni, me pak të ardhura nga jashtë institucionit. Në këtë kontekst shumica e të ardhurave rrjedhin nga pagesa e studentëve. Kjo pjesëmarrje e të ardhurave nga pagesa e shkollimit me këtë nivel ka të ngjarë të mbetet në të ardhmen e afërt, duke e bërë atë si burim kryesor të të ardhurave për Universitetin. Burime shtesë të të ardhurave kanë origjinën në aktivitetet e shërbimeve të tjera universitare (duke ofruar trajnime për kompanitë e jashtme ose hartimin e programeve zhvillimore për bizneset. Një burim tjetër financimi i operacioneve të Universitetit është buxheti i shtetit i cili për të tretin vit radhazi ka vazhduar të subvencionojë Universitetin, i cili ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm në ruajtjen e ofrimit të arsimit me cilësi të lartë nga UEJL. Interesi nga depozitat bankare afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe investimet në fondet e investimeve me rrezik të ulët janë një shtesë tjetër në buxhetin e Universitetit.

Duhet pasur parasysh se toka në të cilën ndodhet kampusi i Tetovës nuk i përket Universitetit apo Fondacionit, por Qeverisë dhe përdoret në bazë të një marrëveshje afatgjate.

Nëse ne kemi një vështrim të afërt në portofolin e të ardhurave për vitin akademik 2016/2017 është si më poshtë: pagesa e shkollimit paraqet 87.28% e të ardhurave, të ardhurat komerciale janë 1.77%, aktivitetet financiare janë 1.17%, projektet 0.49% dhe subvencionet nga shteti janë pjesa e mbetur 9.29%.

Siç mund të shihet, ekziston një mbështetje e madhe në pagesat e shkollimit nga studentët, që do të thotë ekspozim financiar i Universitetit ndaj ndryshimeve demografike ose mangësive në regjistrimin e studentëve. Është e dëshirueshme të identifikohen dhe të ndiqen burime shtesë të të ardhurave dhe të diversifikohen rrjedhat e të ardhurave.

PJESA E MJETEVE NGA BUXHETI NË TOTALIN E MJETEVE

Sipas të dhënave më të fundit, totali i mjeteve të Universitetit është 1,211,532,000 MKD. Për vitin fiskal 2016, të ardhurat nga pagesa e shkollimit dhe donacionet për bursa ishte 237,203,000 MKD. Të ardhurat totale për atë vit ishin 490,949,000 MKD.

PJESA E MJETEVE NGA PAGESA SHKOLLIMIT NË TOTALIN E MJETEVE

Sipas numrave, pjesëmarrja e pagesave të studentëve në totalin e mjeteve është 19.58%.

9. Mjedisi dhe shërbimet në kampus

9.1. Mbështetja studentore

Mbështetja e studentëve kryesisht është realizuar nëpërmjet Shërbimeve studentore dhe Zyrës për ndihmë financiare. Studentët për vitin akademik 2016/2017 janë përkrahur financiarisht nëpërmjet programit të bursave të universitetit, grantet e donatorëve të bursave, programi “*Punë dhe studime*”, si dhe programi financiar-zbritje për studentin e dytë dhe të tretë të

familjes, në gjithsej rreth 25% të studentëve të rregullt në studimet deridiplomike financiarisht janë përkrahur në një farë mase.

Programi i bursave përbëhet nga dy grupe: bursat meritore të universitetit në bazë të rezultateve të treguara nga vlerësimi paraprak i diturive dhe bursat në bazë të nevojës financiare, në bashkëpunim me Fondacionin për shoqëri të hapur. Në nivel të Universitetit 317 bursa janë dhënë, d.m.th. 255 bursa meritore dhe 53 në bazë të nevojës financiare 9 bursa nga komuniteti i biznesit, që do thotë se 17.7% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt janë përkrahur me bursa që mbulojnë pjesërisht apo gjithë tarifën e shkollimit në programin e studimit përkatës.

Nga pikëpamja financiare, rreth 2.6 % studentëve të rregullt janë përkrahur nëpërmjet programit *“Punë dhe studime”*. Përmes këtij programi, studentët u angazhuan në shërbimet e ndryshme të universitetit duke përfituar nga përvoja relevante nga edhe realizojnë mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik, 46 studentë ishin të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL është bërë zbritje e pagesës së shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Nëpërmjet këtij programi të Universitetit janë mbështetur 86 studentë, çka përfaqëson 4.8% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt.

Vëmendje e veçantë i është dhënë zhvillimit të qasjes efektive për studentët me nevoja të veçanta dhe mundësitë për bursa për këtë grup të studentëve.

UEJL në bashkëpunim me komunitetin e biznesit ka dhënë 9 bursa që mbulojnë 100% të pagesave të shkollimit në programe të ndryshme. Kjo është dëshmuar si një shtesë e vlefshme për instrumentet ekzistuese për mbështetjen e studentëve dhe kjo do të ndihmojë për të ruajtur lidhjet e forta me kompanitë që duan të mbështetin studentët e UEJL-së me bursa.

9.2. Ngrehinat dhe kapacitetet teknike

Ambientin në të cilin vepron Universiteti i Evropës Juglindore është shembull për vendin edhe për rajonin se si duhet të duket një ambient arsimor, duke reflektuar kulturë të lartë organizative të bazuar në standardet evropiane por edhe duke e pas si objektiv edhe aspektin e ambientalizmit. Edhe më tutje me të madhe vazhdohet të investohet në projekte të cilat kanë për qëllim ruajtjen e ambientit. Vitin e kaluar janë zëvendësuar dritat e neonit me drita LED të cilat kursejnë energji dhe nuk e ndotin ambientin. Sistemi i nxehjes vazhdon të bëhet me biomasë dhe të prodhohet energji elektrike me panelet fotovoltaike. Edhe këtë vit ka vazhduar automatizimi i ujitjes në hapësirat jeshile duke mbuluar një sipërfaqe shtesë prej 3600 m² me ujitje automatike, e cila gjithashtu ka ndihmuar në kursimin e ujit dhe energjisë elektrike.

Shërbimi i mirëmbajtjes gjithmonë punon në automatizimin e proceseve që i bën ata më të kontrolluar dhe më lehtë të menaxhuar. Shumica e proceseve integrohen në ISO standarde me të cilët Universiteti ka kohë që është familjarizuar. Vetë pamja e jashtme që le përshtypje çdo vizitori, flet për një nivel të lartë të kontrollit dhe kujdesit të veçantë në planifikim dhe realizimin e detyrave me përpikëri të madhe.

Gjithmonë tentohet që mirëmbajtja e planifikuar të jetë efektive dhe efikase me qëllim që sa më pak t'i lehet rastit, gjegjësisht të praktikohet një mirëmbajtje që e përmirëson në kontinuitet performancën e shërbimit dhe i redukton të papriturat. Departamenti i mirëmbajtjes ia del me fuqi punëtore të optimizuara t'i arrijë qëllimet e planifikuara. Struktura e re në mënyrë më të saktë bën caktimin e përgjegjësive dhe autorizimeve për të gjithë të punësuarit në departament, posaçërisht për udhëheqësit e njësive që ndihmon në menaxhimin më të mirë. Kjo lidhet edhe me zbatimin e standardeve të shërbimit dhe kontrollit dinamik të tyre duke përmirësuar mirëmbajtjen e kapaciteteve teknike në të gjitha segmentet. Dëshmi për këtë përmirësim janë edhe rezultatet e larta nga anketimet e rregullta me stafin dhe studentët edhe pas aplikimit të strukturës organizative me staf të optimizuar. Gjitha këto aktivitete të cekura, në funksion të përmirësimit të kapaciteteve teknike dhe ngrehinave në hapësirat e kampusit, vazhdojnë t'i japin Universiteti një përparësi konkurruese në krahasim me institucionet tjera të arsimit të lartë edhe në këtë domen.

9.3. Qendra e UEJL-së në Shkup

Kampusi i Universitetit të Evropës Juglindore në Shkup është vendi i aktivitetit të UEJL-së në kryeqytetin e Maqedonisë. Gjatë periudhës kohore prej orës 08:00-16:00 çdo të hënë deri të premten ofrohen aktivitete për studimet deridiplomike dhe çdo të dytën fundjavë për studimet e magjistraturës. Stafi administrativ i kampusit të Shkupit është me qëndrim të përhershëm në Shkup dhe siguron të njëjtin standard shërbimi për studentët e Shkupit, siç është siguruar nga stafi i kampusit të Tetovës.

Përveç përpjekjeve kryesore të UEJL-së në Shkup, pra sigurimi i mësimdhënies kurrikulare – në UEJL Shkup gjithashtu organizohen shumë takime të Universitetit, siç janë mbledhjet e Rektoratit, Bordit, të Parlamentit studentor dhe organeve të tjera të ngjashme. UEJL Shkup është gjithashtu një vendndodhje primare institucionale për pritjen e folësve të nderuar të ftuar, konferenca dhe punëtori të vogla, promovime libri dhe ngjarje promovionale të Universitetit. Kampusi i Shkupit mbështet një numër aktivitete të informimit të komunitetit, siç janë finalët e fundit të "Spelling Bee" për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, ose të tilla si sigurim të hapësira për sesione të shumëfishta të Këshillit Britanik. Së fundi, kampusi i UEJL-së në Shkup, gjatë periudhës së këtij raporti, ofroi asistencë themelore logjistike për universitetin e sapoformuar "Nënë Tereza", duke lejuar përfaqësuesit e UNT-së përkohësisht në ambientet e UEJL-së në Shkup të bëjnë regjistrimin e studentëve. Ky bashkëpunim tashmë ka përfunduar, siç është parashikuar.

Mësimdhënësit dhe administratorët në kampusin e UEJL-së në Shkup kanë luajtur një rol aktiv në promovimin, rekrutimin dhe aktivitetet e regjistrimit, gjatë periudhës së këtij raporti; ky proces u ndihmua shumë nga takimet javore të stafit të kampusit të Shkupit për informim, shkëmbim të informacionit dhe diskutim.

Stafi i Shkupit përpiqet të sigurojë një jetë gjallëruese kulturore për studentët, qoftë përmes postimit të njoftimeve lidhur me argëtimet e ardhshme muzikore, ose thjesht duke vënë në dispozicion pajisjet. Synimi kryesor i mësimdhënësve dhe administratorëve të UEJL-së në Shkup është të ruajë cilësinë e lartë të përvojës së studentëve nga Tetova.

9.4. Burimet njerëzore

Zyra e burimeve njerëzore edhe gjatë vitit akademik 2016-2017 konform kompetencave dhe autorizimeve të zyrës është angazhuar të zbatojë planin strategjik të Universitetit lidhur me zhvillimin e burimeve njerëzore, rekrutimin e stafit kualitativ administrativ dhe akademik duke pasur bazë mbështetëse parimin e mundësive të barabarta. Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe trajnimit dhe zhvillimit të stafit të Universitetit në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për cilësi.

Universiteti edhe këtë vit me sukses ka vazhduar me udhëheqjen, procedimin dhe promovimin e stafit akademik në titull mësimorë-shkencorë. Të gjitha këto aktivitete janë përmbyllur me sukses dhe në kohë gjë e cila është verifikuar edhe nga kontrolli i inspektionit të Ministrisë së Arsimit për të gjitha avancimet për tituj mësimorë-shkencorë nga viti akademik 2013-2014 deri më 2016-2017.

Zyra e Burimeve Njerëzore gjatë vitit akademik 2016-2017 ka filluar me realizimin e procesit të optimizimit të stafit administrativ, proces ky i cili akoma vazhdon. Në fazën e parë të procesit janë grumbulluar në formë elektronike të gjitha të dhënat lidhur me kualifikimin, përvojat dhe shkathtësitë për stafin administrativ.

Për të siguruar nivelin e lartë të cilësisë së burimeve njerëzore të Universitetit rëndësi e veçantë i është kushtuar procesit të rekrutimit të stafit administrativ me kaudro përkatëse si nga brenda ashtu edhe nga jashtë Universitetit. Rëndësi e veçantë gjithashtu i është kushtuar edhe kontrollimit apo respektimit të orarit të punës nga stafi administrativ dhe akademik.

Në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin e teknologjive informative është vazhduar me angazhimin rreth vënies në zbatim të softuerit të përbashkët të Zyrës së burimeve njerëzore me Zyrën e planifikimit akademik dhe Zyrën e financave nga ku pritet të rezultojë edhe llogaritja elektronike e rrogave.

Gjatë vitit akademik 2016-2017 të punësuar janë **261** punonjës të Universitetit të Evropës Juglindore. Ata janë të shpërndarë si më poshtë. Ka **148** anëtarë të stafit akademik, **100** prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa **48** të tjerë janë të punësuar me kohë të pjesshme. Janë **113** staf administrativ, prej të cilëve **105** janë të punësuar me kohë të plotë, dhe **8** janë të punësuar me kohë të pjesshme.

Në universitet si staf akademik ka **148** të punësuar; ku **100** janë me angazhim të plotë dhe **48** me angazhim të pjesshëm. Nga stafi akademik me angazhim të plotë, në aspekt të titujve mësimorë –shkencorë kemi këtë shpërndarje, **18** profesorë ordinarë; **31** profesorë inordinarë; **22** docentë; **8** doktorë shkencash pa titull mësimor-shkencor; **21** magjistra. Nga stafi akademik me angazhim të pjesshëm, në aspekt të titujve mësimorë –shkencorë kemi këtë shpërndarje: **8** profesorë ordinarë; **10** profesorë inordinarë; **9** docentë; **4** doktorë shkencash pa tituj mësimorë-shkencorë; **9** magjistra dhe **8** me diplomë universitare.

Në universitet si staf administrativ ka **113** të punësuar; ku **105** janë me angazhim të plotë dhe **8** me angazhim të pjesshëm. Nga stafi administrativ me angazhim të plotë, **5** janë doktorë shkencash; **15** magjistra dhe **59** me diplomë universitare; ka edhe **26** të punësuar që nuk kanë

të mbaruar edukim terciar. Nga stafi administrative me orar të pjesshëm ka **1** doktor shkencash; **2** magjistra dhe **5** me diplomë universitare.

Numri më i lartë i të punësuarve në pesë vitet e fundit është regjistruar në vitin 2012, kur kishte një total prej 347 të punësuarish (254 me kohë të plotë dhe 93 me kohë të pjesshme). Këta numra janë ulur në mënyrë të vazhdueshme përmes reduktimit të qëllimshëm të mbështetjes në stafin me kohë të pjesshme, optimizime dhe daljet në pension ose dorëheqjeve. Këto trende janë si në vazhdim: në vitin 2013 gjithsej kishte 320 të punësuar, nga të cilët 249 me kohë të plotë dhe 71 me kohë të pjesshme. Më 2014 gjithsej kishte 300 të punësuar, nga të cilët 229 me kohë të plotë dhe 71 me kohë të pjesshme. Më 2015 gjithsej kishte 285 të punësuar, nga të cilët 223 me kohë të plotë dhe 62 me kohë të pjesshme. Më 2016 gjithsej kishte 278 të punësuar, nga të cilët 221 me kohë të plotë dhe 57 me kohë të pjesshme. Siç u përmend më lartë, në vitin 2017 gjithsej ka 261 të punësuar nga të cilët 205 me kohë të plotë dhe 56 me kohë të pjesshme.

9.5. Sistemet e informacionit

Duke qenë një ndër hallkat e rëndësishme në Universitet në drejtim të mbështetjes së proceseve administrative, departamenti i TI-së ka vazhduar me zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve elektronike. Sa i përket sistemit për planifikim akademik dhe menaxhim të angazhimeve akademike kemi punuar në drejtim të përsosjes së sistemit ekzistues. Bazuar në nevojat reale dhe problemet e ndeshura gjatë përdorimit të sistemit në kushte reale kemi zhvilluar opsione që e risin fleksibilitetin e sistemit me qëllim rritjen e efikasitetit gjatë planifikimit të angazhimeve akademike. Gjithashtu është rritur dhe sofistikuar niveli i integritetit të këtij sistemi me modulën e llogaritjes së rrogave që është pjesë e sistemit të ERP-së. Tani, bazuar në angazhimet akademike të cilat janë edhe të aprovuara nga menaxhmenti, në fund të çdo muaji sistemi bën përlllogaritje të rrogave për muajin rrjedhës. Kjo tani do të jete bazë e plotë për gjenerim të raporteve të detajuara për rrogën e akademisë.

Sa u përket zhvillimeve dhe përmirësimeve tjera që kanë të bëjnë me ERP-në vlen të theksohet se është zhvilluar sistemi i paralajmërimeve të hershme për zëra të caktuar buxhetorë. Për këtë ishte e nevojshme që së pari të revidohen raportet elektronike për likuiditet dhe buxhet dhe të definohet biznes logjika për kufijtë për aktivizim të alarmeve.

Gjatë këtij viti akademik është punuar paralelisht edhe në drejtim të migrimit të sistemit UMS në WEB aplikacion. Kjo bëhet për dy arsye. Arsyeja e parë është për të respektuar përcaktimin afatmesëm të Universitetit për kalim të sistemeve elektronike në 'cloud', dhe arsyeja e dytë është përmirësimi dhe mbindërtimi i vazhdueshëm i sistemit bazuar në nevojat reale që zhvillohen dhe ndryshojnë në bazë të rrethanave të reja. Për këtë qëllim kemi zhvilluar një WEB platformë të re (<https://ums.seeu.edu.mk>) dhe në të kemi zhvilluar module të reja si moduli për 'internship'-e për qendrën e karrierës, moduli për departamentin e mirëmbajtjes, ...etj. dhe gjithashtu kemi realizuar migrim të disa moduleve të 'desktop' UMS aplikacionit në WebUMS si që është moduli për menaxhim të 'Research Database'.

Në drejtim të përmirësimit të proceseve administrative, gjatë këtij viti akademik kemi marrë edhe me revidimin dhe përmirësimin e procedurës për prokurim si dhe sistem elektronik për prokurim. Ky sistem është në përdorim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe si rezultat i nevojave reale u paraqit nevojë për revidimin dhe përmirësimin e sistemit. Bazuar në

procedurën e rishkruar për prokurime e kemi zhvilluar sistemin e ri për prokurime dhe ky tani më është duke u testuar në mënyre intensive para se të lëshohet në përdorim. Besojmë se me lëshimin në përdorim të sistemit të ri për prokurime do të ngrihet efikasiteti i prokurimeve dhe do të ndikojë në përmirësimin dhe optimizimin e shpenzimeve.

Për të qenë në hap me kohën dhe për të mundësuar përmirësime të vazhdueshme të sistemeve elektronike, kuptohet, duhen edhe investime të konsiderueshme për TI infrastrukturën e Universitetit. Në këtë drejtim Universiteti ka investuar mjete të konsiderueshme për zëvendësimin e TI pajisjeve në data qendrën kompjuterike. Me sukses është bërë zëvendësimi i të gjitha pajisjeve të vjetruara me pajisje moderne. Të gjitha sistemet elektronike i kemi migruar me sukses dhe gati pa ndërprerje në mbarëvajtjen e punëve të Universitetit. Pajisjet e reja kanë mundësuar virtualizim të shërbimeve në shkallë më të avancuar gjë që ka kontribuar në uljen e numrit të serverëve fizik. Me uljen e numrit të pajisjeve fizike si rrjedhojë kemi ulje të konsiderueshme të shpenzimeve si nga aspekti i konsumit të energjisë elektrike po ashtu edhe nga aspekti i mirëmbajtjes së tyre.

Krejt këto zhvillime, ndryshime dhe përmirësime në fushën e teknologjisë së informacionit dëshmojnë se Universiteti në vazhdimësi demonstroi dedikim në ndjekjen dhe implementimin e praktikave më të mira në botë në fushën e teknologjisë së informacionit.

9.6. Shërbimet e bibliotekës

Biblioteka "Max van Der Stoel" është një bibliotekë institucionale në shërbim të qëllimeve hulumtuese dhe arsimore të Universitetit të Evropës Juglindore. Biblioteka ka një hapësirë të përshtatshme në objektin 702. Biblioteka ka dy lokacione - bibliotekën qendrore në kampusin në Tetovë "Max van der Stoel", si dhe degën e bibliotekës të vendosur në kampusin në Shkup. Në kohën e këtij raporti, bibliotekat gjithsej kanë një fond prej 32,479 libra të veçantë, që mbulojnë 15859 tituj të ndryshëm.

Fondi kryesor i bibliotekave është në fushat e këtyre lëndëve që mësohen në Universitet, me shtimin e materialeve të përgjithshme të referencës dhe libra të njohura të interesit. Shumica e librave janë në dispozicion për 'check-out' dhe studim në shtëpi, edhe pse veprat e referencës duhet të qëndrojnë në ambientet e bibliotekës. Biblioteka gjithashtu shërben si vend qendror për shfaqje të atyre dokumenteve që janë vënë në dispozicion të komunitetit para se të paraqiten në Këshillin akademik të Fakultetit, të tilla si disertacioneve të magjistraturës ose doktoratës në pritje të mbrojtjes, ose raportet e recensioneve për proceset promovuese për titull akademik. Biblioteka gjithashtu si vend për ruajtje tezave të magjistraturës dhe doktoratës pas mbrojtjes së tyre, në mënyrë që ata janë në dispozicion për konsultim shkencor. Biblioteka ka në dispozicion edhe këndet të vendosura nga Bashkimi Evropian si dhe Banka Botërore për të cilët është siguruar një hapësirë e pajisur me dokumentet dhe databazën e Bankës Botërore.

Biblioteka i kreu me sukses punët e saj të rregullta për nevojat e studentëve dhe stafit akademik me shërbimet e nevojshme, pra me libra dhe materiale elektronike, nëpërmjet fondit ekzistues të librave në bibliotekë dhe databazave të disponueshme EBSCO dhe EKON-BIZ. Gjithashtu me saktësi, efikasitet dhe në kohë të duhur janë përpunuar, janë klasifikuar dhe janë katalogizuar të gjitha librat e rinj të blerë, posaçërisht fondi i librave të Qeverisë, të donuara nga ASHAM si dhe në proces e sipër është digjitalizimi dhe katalogizimi i punimeve master dhe

punimeve të doktoratës me qëllim që ato të mund të shihen në katalogun e bibliotekës ku do të kenë qasje edhe studiues të jashtëm. Gjithashtu me lehtësi janë bërë edhe transferet e materialeve të duhura për Bibliotekën në Shkup dhe anasjelltas. Gjatë gjithë kohës është organizuar fushatë permanente për përdorimin e databazave si të studentët e rinj ashtu edhe tek të tjerët. Gjithë këto veprime janë mundësuar falë stafit profesionist, efikas dhe të devotshëm të bibliotekës. Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me Bibliotekën kombëtare dhe universitare Shkup, veçanërisht huazimit të materialeve që ne nuk i posedojmë si dhe me Bibliotekën universitare të Kosovës. Gjatë kësaj kohe biblioteka u ka kushtuar një rëndësi të posaçme edhe promovimeve të librave nga autorët vendorë me rëndësi shkencore dhe kulturore. Ndiqma në bibliotekë është në dispozicion për të gjithë studentët, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme dhe të gjithë stafin. Shërbimet kryesore të ofruara janë natyrshëm në vendndodhjen dhe ofrimin e librave në bibliotekë në të dy kampuset. Stafi bibliotekës gjithashtu ndihmon në kontrollin, kthimin dhe rivendosjen e librave që kanë qenë të huazuar nga studentët ose anëtarët e stafit. Kërkesat për "rezervimin" e librave mund të bëhen personalisht ose online. Materialet joreferuese zakonisht mund të huazohen dhe të rinovohet kërkesa edhe pse për veprat veçanërisht të njohura ose të rralla mund të refuzohet një kërkesë për të ripërtërirë një libër. Në suksesin e punës kanë kontribuar edhe studentët e "Work&Study" të aftësuar nga stafi i bibliotekës.

9.7. Parlamenti dhe Asociacioni studentor

Parlamenti dhe Asociacioni studentor është njësia primare për zërin dhe përfaqësimin e studentëve në Universitet. Është një asamble e zgjedhur, e cila pas zgjedhjeve, zgjedh zyrtarët e vet. Përfaqësuesit e Parlamentit shërbejnë si anëtarë pa të drejtë vote në Senatin e Universitetit dhe anëtarët e tjerë shërbejnë në ekipet e cilësisë të fakulteteve.

Parlamenti studentor vepron si për të përfaqësuar dhe për t'u shërbyer studentëve. Prandaj, shumica e punës së tyre është konsultative dhe këshilluese, zakonisht në kapacitetet e mësipërme. Përveç kësaj, PAS shërben për të siguruar studentët me argëtim dhe mundësi sociale, të tilla si tubime shoqërore, vallëzime dhe duke ndihmuar me aranzhimet për ekskursionin 'Eurotrip' dhe këshillimin për punën dhe mundësitë e udhëtimit.

9.8. Sporti dhe rekreacioni

Edhe në fushën e sportit dhe rekreacionit Universiteti ka qenë aktiv në vitin akademik 2016/17. Si detyrë parësore ka vazhduar të jetë masivizimi i sportit në kampuset e Universitetit në Tetovë dhe Shkup. Për këto qëllime janë bërë anketime të ndryshme me studentët në mënyrë që të informohemi për cilat sporte studentët janë më të interesuar. Në bazë të informatave të marra janë shtuar aktivitetet organizative në sporte të caktuara, duke marrë parasysh gjithashtu edhe kapacitetet dhe kushtet që Universiteti i ka për zhvillimin e atyre aktiviteteve.

Janë organizuar aktivitete sportive intensive në kampuset e Universitetit dhe jashtë kampuseve. Aktivitetet e organizuara kanë variuar nga ato të përditshme si futboll, basketbolli, volejboli, tenisi, ping-pong, shah dhe fitnes, si dhe evenimente të cilat organizohen periodikisht në formën e turnireve në disiplina të ndryshme sportive - futboll, basketboll, ping-pong, shah, tenis, alpinizëm dhe ruta me biçikleta.

Në këtë kontekst vlen të ceket pjesëmarrja e studentëve në garat në skijim në Shqipëri, organizimi i një ekspedite malore në majën e Malit Korab si dhe rutat tjera alpiniste. Gjithashtu janë organizuar edhe disa ruta me biçikleta. Për të siguruar kushte të mira për sport për studentët e kampusit të Shkupit, Universiteti ka siguruar termin për sport në sallë dhe në pishinë në qendrën "Boris Trajkovski" gjë e cila ka ndihmuar në popullarizimin dhe masovizimin e sportit mes studentëve.

Përveç këtyre aktiviteteve vlen të ceket edhe vazhdimi i pjesëmarrjes së ekipit universitar në kampionatin shtetëror për futsal ku ka shënuar rezultate mbresëlënëse. Për fat të keq, për shkak të ndërprerjes së organizimit të garave ndëruniversitare nga autoritetet, studentët e Universitetit këtë vit nuk kanë mundur t'i dëshmojnë cilësitë e veta edhe në këtë format garimi. Përndryshe aktivitetet sportive që janë zhvilluar në kuadër të sektorit të sportit mund të ndahen në disa nivele edhe atë:

Në fund mund të themi se viti akademik 2016/17 ka qenë mjaft i suksesshëm në domenin e kyçjes së studentëve në aktivitete sportive, por edhe me rezultate të dalluara sportive. Përndryshe, në domenin e sportit, për Universitetin ngelën si objektiv në të ardhmen ndërtimi i një sale sportive e cila do e rrumbullakësonte infrastrukturën sportive në kampus dhe do jepte kushtet e nevojshme moderne për praktikim të sportit dhe aktiviteteve rekreative për të gjithë studentët dhe stafin.

10. Konkluzionet

Universiteti i Evropës Juglindore mban një pozitë të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë dhe më gjerë, si nëpërmjet përsosmërisë së ofertave akademike ashtu edhe nëpërmjet ofrimit të shembullit të bashkëpunimit efektiv multietnik dhe shumëgjuhësh.

Ky raport kërkon të paraqesë të dy aspektet, anët e forta dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Universiteti në kohën e përpilimit të tij. UEJL kërkon të identifikojë sinqerisht dobësitë e tij dhe të punojë me zell për t'i adresuar ato. Për të përdorur në mënyrë produktive këtë raport, sugjerimet e mëposhtme janë përpunuar nga seksionet e ndryshme të këtij raporti. Universiteti duhet të kërkojë që:

- ❖ ta stabilizojë regjistrimin e studentëve në ciklin e parë;
- ❖ ta ruajë pozitën udhëheqëse rajonale në studimet e ciklit të dytë dhe të tretë;
- ❖ t'i diversifikojë burimet e të ardhurave nëpërmjet bashkëpunimit inovativ me partnerët e biznesit dhe social;
- ❖ ta formalizojë subvencionin bujar të qeverisë në një marrëveshje të strukturuar dhe të rregullt;
- ❖ ta përmirësojë shkallën e diplomimit në kohë;
- ❖ t'i forcojë burimet e hulumtimit (qasje në bazën e të dhënave) për studentët në studimet pasuniversitare dhe stafin;
- ❖ të zhvillojë një asociacion aktiv të Alumnit.

Universiteti i Evropës Juglindore përballet me vështirësi të parashikueshme në të ardhmen afatshkurtër dhe afatmesme, por është institucionalisht i përgatitur mirë për të përmbushur këto sfida. Universiteti ka një reputacion të shkëlqyer për standardet e larta të mësimit akademik; ka instrumente të gjera dhe të provuara të sigurimit të cilësisë dhe politika; ofron një model të edukimit multietnik, multilingual dhe multikulturor që është unik në nivel kombëtar dhe rajonal; dhe ka një staf bashkëpunues dhe kolegjal si akademik dhe administrativ. Megjithëse, sfidat përpara nuk duhet të nënvlerësohen, Universiteti i Evropës Juglindore mbetet një nga institucionet më të mira arsimore në Republikën e Maqedonisë dhe në rajonin e Ballkanit dhe ka shpresa të justifikuara për vazhdimin e ruajtjes së kësaj ekselence.

Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit

- ❖ Provosti
- ❖ Sekretari i përgjithshëm
- ❖ Prorektori për ndërmarrësi dhe planifikim
- ❖ Këshilltarja ekzekutive për cilësi
- ❖ Përgjegjësi i Qendrës së UEJL-së Shkup
- ❖ Drejtori i Shërbimeve studentore
- ❖ Përgjegjësi i Qendrës së karrierës
- ❖ Përfaqësues të të gjithë pesë fakulteteve
- ❖ Drejtori i Qendrës së gjuhëve
- ❖ Drejtori i Qendrës për eMësim
- ❖ Përfaqësues të Parlamentit studentor
- ❖ Asistenti për sigurimin e cilësisë, përkrahje teknike

(Komiteti dëshiron gjithashtu t'i mirënjohë kontributet e bëra nga Fikret Shabani në përmbajtjen e këtij raporti dhe punën e Daniela Ilievskës dhe Rexhep Xheladinit për përkthimin, si dhe Burim Ismailit për formatimin teknik të dokumentit.)